



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE SANKSIONEVE**

Data: 11.6.2024

Nr: 12

Ora: 11:00

**VENDIM**  
**PËR**

**SHQYRTIMIN E KËRKESAVE ANKIMORE NR. 5, DEPOZITUAR “PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË”, NR. 6, TË DEPOZITUAR NGA “PARTIA ARDHMËRIA SHQIPTARE” DHE NR. 7, DEPOZITUAR NGA “BINDJA DEMOKRATIKE”**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 11.6.2024, me pjesëmarrjen e:

Elvis	ÇEFA	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

**ANKUES:**

1. Partia Socialiste e Shqipërisë;
2. Partia Ardhmëria Shqiptare;
3. Partia Bindja Demokratike.

**OBJEKT:**

Kundërshtim i vendimit nr. 38, datë 09.04.2024 “Për miratimin e raportit mbi gjetjet nga auditimi i raporteve financiare të partive politike për të ardhurat dhe shpenzimet për vitin kalendarik 2022”, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

**BAZË LIGJORE:**

Nenet 21, pika 1, shkronja “dh”, 132 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenin 19 të vendimit nr.03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”.

Data: 11.6.2024 Nr: 12  
Ora: 11:00



“Për shqyrtimin e kërkesave ankimore nr. 5, depozituar “Partia Socialiste e Shqipërisë”, nr. 6, depozituar nga “Partia Ardhmëria Shqiptare” dhe nr. 7, depozituar nga “Bindja Demokratike”

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

### Rrethanat e çështjes:

1. Në nenin 23 të ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000, "Për partitë politike", të ndryshuar, përcaktohet detyrimi i partive politike për të dorëzuar 1 (një) herë në vit në KQZ raportet financiare, të cilat duhet të mbajnë informacion të hollësishëm për:
  - a. Burimet e financimit në bazë të formatit të standardizuar;
  - b. Shpenzimet në bazë të formatit të standardizuar;
  - c. Subjektet e lidhura drejtpërdrejtë ose tërthorazi me partitë politike apo që kontrollohen prej tyre.

Neni 2, pika 1, i udhëzimit nr. 10, datë 21.4.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, "Për përcaktimin e rregullave për raportimin financiar vjetor të partive politike, kontrollin dhe verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre dhe mënyrën e pagesës së audituesve", përcakton dorëzimin e raporteve financiare nga partitë politike më 31 mars të vitit pasardhës.

2. Sipas të dhënave të Zyrës së Regjistrimit të Partive Politike pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, deri në datën 31 Dhjetor 2022, figurojnë të regjistruara 131 (njëqind e tridhjetë e një) parti politike.

Nga këto, vetëm 48 parti dorëzuan në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve raportin financiar vjetor për të ardhurat dhe shpenzimet për vitin kalendarik 2022. Dorëzimi i raportit u bë brenda datës 31 Mars 2023, si afat i përcaktuar nga ligji. KQZ ka caktuar auditues për gjitha raportet financiare të subjekteve zgjedhore.

3. Bazuar sa më sipër, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka marrë në shqyrtim raportet e gjetjeve të auditëve të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike për vitin kalendarik 2022. Në përfundim të procedurës administrative, Komisioneri nëpërmjet vendimit nr. 38, datë 9.4.2024 "Për miratimin e raportit mbi gjetjet nga auditimi i raporteve financiare të partive politike për të ardhurat dhe shpenzimet për vitin kalendarik 2022", ka vendosur marrjen e masës administrative gjobë për disa subjekte zgjedhore, ndër të cilët edhe për subjektet ankimese si më poshtë:

a) Për Partinë Socialiste të Shqipërisë, KSHZ ka vendosur masën administrative gjobë në vlerën 60 000 lekë, sipas nenit 23/4, pika 1 të ligjit "Për Partitë Politike" duke u referuar në gjetjet e audituesit si më poshtë:

- *Partia nuk llogarit amortizim për ndërtesën që e ka me huapërdorje sipas vendimit nr. 196, datë 19.5.1992 të Këshillit të Ministrave. Vlera e ndërtesës me huapërdorje nuk është e rivlerësuar sipas kërkesave ligjore dhe paraqitet me vlerën e vitit 1993. Llogaritja e amortizimit bëhet sipas kërkesave të nenit 22, shkronja b të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, i ndryshuar.*
- *Partia nuk ka paraqitur të ndarë aktivitetin e saj vjetor të zakonshëm dhe aktivitetin për fushatën zgjedhore të datës 6.3.2022.*

Data: 11.6.2024 Nr: 12  
Ora: 11:00



Për shqyrtimin e kërkesave ankimore nr. 5, depozituar "Partia Socialiste e Shqipërisë", nr. 6, depozituar nga "Partia Ardhmëria Shqiptare" dhe nr. 7, depozituar nga "Bindja Demokratike"

- *Pagesat e kryera për shpërblimin e fund vitit si dhe pagesat për punë shtesë nga disa punonjës të saj, nuk janë përfshirë në listë pagesat e raportuara në organet fiskale. Për të gjitha këto pagesa, është llogaritur dhe është raportuar gabim tatimi në burim me tarifë 15% kur duheshin raportuar si të ardhura personale duke llogaritur tatim mbi pagën për secilin punonjës.*
  - *Nuk janë kaluar nëpërmjet llogarive bankare pagesat ndaj disa punonjësve të jashtëm që kanë punuar për llogari të partisë, si dhe pagesat e shpërblimit të fund vitit.*
- b) Për Partinë Ardhmëria Shqiptare, KSHZ ka vendosur masën administrative gjobë në vlerën 60 000 lekë, sipas nenit 23/4, pika 1 të ligjit “Për Partitë Politike” duke u referuar në faktin se audituesi ka konstatuar se kjo parti rezulton në listën e subjekteve me status pasiv dhe nuk ka kryer auditimin.
- c) Për Partinë Bindja Demokratike KSHZ ka vendosur masën administrative gjobë në vlerën 1 000 000 lekë, sipas nenit 23/4, pika 2 të ligjit “Për Partitë Politike” duke u bazuar në raportimet e audituesit i cili megjithëse ka komunikuar me financierin e partisë më shumë se një herë, nuk i është dërguar asnjë informacion dhe si rrjedhojë nuk ka marrë asnjë të dhënë për të kryer auditimin në këtë parti politike.
4. Kundër vendimit nr. 38, datë 9.4.2024 “Për miratimin e raportit mbi gjetjet nga auditimi i raporteve financiare të partive politike për të ardhurat dhe shpenzimet për vitin kalendarik 2022”, të KSHZ, kanë bërë ankim në KAS vetëm tre subjekte. Koncretisht: “Partia Socialiste e Shqipërisë”, “Partia Ardhmëria Shqiptare” dhe Partia “Bindja Demokratike”.
5. Partia Socialiste e Shqipërisë në kërkesën ankimore nr. 5, datë 08.5.2024 drejtuar KAS ka parashtruar si më poshtë:
- *Referuar pikës nr. 46 të vendimit nr. 38/2024 të KSHZ, ku audituesja ka konstatuar se nuk është llogaritur amortizimi për ndërtesën me huapërdorje dhe mosrivlerësimin e vlerës së kësaj ndërtese, ju bëjmë me dije se sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 402, datë 01.11.1991, dhe shkresës nr. 1211/1, date 20.05.1992, ndërtesën e kemi në përdorim dhe jo me huapërdorje. Si rezultat, në fillim për efekt raportimi i është vënë një vlerë 1.643.389 lek. Kjo vlerë është raportuar e njëjtë për 30 vjet në pritje të kalimit në pronësi dhe kjo është dhe arsyeja e mos rivlerësimit dhe për rrjedhojë dhe llogaritjes së amortizimit.*
  - *Konstatimi tjetër se nuk është paraqitur i ndarë aktiviteti vjetor i Partisë dhe aktiviteti për fushatën zgjedhore të 6 Marsit 2022, nuk qëndron, sepse në Bilanc është përfshirë si aktiviteti vjetor i zakonshëm, ashtu edhe aktiviteti për fushatën e 6 Marsit, fakt të cilin vetë audituesja e ka cilësuar. Fushata e 6 Marsit 2022 është raportuar sipas ligjeve të KQZ dhe është audituar veç.*
  - *Për pagesat e shpërblimit të fundvitit dhe të punonjësve me honorar nuk qëndron pretendimi që është llogaritur gabim tatimi i pagave, gjë që i është argumentuar auditueses me dokumenta përkatëse nga Kryefinancierja e Partisë. Pra, punonjësve në organikë tatimi i shpërblimit të fundvitit i’u është llogaritur sipas ligjit, por raportimi është*

*bërë te Deklarimi i Tatimit në Burim. Pavarësisht kësaj, shpërblimi i fundvitit të 2023 është bërë sipas rekomandimeve të auditueses.*

- *Lidhur me konstatimin e fundit, ju bëjmë me dije se pagat e punonjësve me honorar janë menduar që të jepen me Arkë, sepse pavarësisht faktit se si paguhen, rëndësi ka që të paguhen detyrimet tatimore ndaj shtetit, gjë të cilën Partia Socialiste e Shqipërisë e bën rregullisht. Por pavarësisht nga kjo, me rekomandimin e auditueses, që nga Nëntori 2023 këto pagesa janë kaluar nëpërmjet llogarive bankare.*

6. Partia Ardhmëria Shqiptare në kërkesën ankimore nr. 6, datë 22.5.2024 drejtuar KAS, në mënyrë të përmbledhur ka parashtruar se:

- *Ky subjekt është gjobitur pa të drejte dhe vendimi i marrë ndaj tij është i pabazuar në ligj, prova dhe fakte. Subjekti i kërkon KAS-it të bëjë një hetim të plotë nëse është shkelur nenin 23/4, pika 1 i ligjit “Për Partitë Politike”.*

7. Partia Bindja Demokratike në kërkesën ankimore nr. 7, datë 29.5.2024 drejtuar KAS, ka parashtruar si më poshtë:

- *Në vendimin e Komisionerit nuk paraqitet asnjë provë dhe rrethanë që vërteton se autoritetet në detyrë të partisë kanë refuzuar të bashkëpunojnë me audituesin.*
- *Në këtë periudhë partia ka qenë pa kryetar në detyrë dhe pa financier, e përpos kësaj ka arritur brenda afateve ligjore të përmbushi detyrimin e saj për dorëzimin e raportit financiar të saj për vitin 2022. I vetmi organ në detyrë në këtë periudhë ka qenë grupi nismëtar. Kjo sepse kryetari i partisë ka dhënë dorëheqje të parevokueshme në shkurt të vitit 2022, i cili është zëvendësuar në këtë detyrë sipas vendimit të gjykatës në qershor të 2023 nga zoti Fabian Topollari.*
- *Shprehim bindjen se organet në detyrë asnjëherë nuk kanë refuzuar bashkëpunimin me audituesit dhe kanë përmbushur të gjitha detyrimet e tyre për dorëzimin në afat të raporteve financiare.*

8. KAS-i mori në shqyrtim dhe administroi:

- Kërkesat Ankimore të depozituara nga tre subjektet ankimuese;
- Vendimin nr. 38, datë 9.4.2024 “Për miratimin e raportit mbi gjetjet nga auditimi i raporteve financiare të partive politike për të ardhurat dhe shpenzimet për vitin kalendarik 2022”, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve;
- Raportin mbi gjetjet nga auditimi i raporteve financiare të partive politike për të ardhurat dhe shpenzimet për vitin kalendarik 2022;
- Raportet e auditimit për të tre subjektet ankuese dhe dokumentacioni bashkëlidhur;
- Pasqyrat Financiare të vitit 2002 të depozituar nga Bindja Demokratike;
- Shkresën e datës 9.10.2023 drejtuar partisë Bindja Demokratike nga audituesi Erjon Saraçi.

9. Në seancë ishin të pranishëm administrata e KQZ-së, përfaqësuar nga Drejtoresha e Ligjshmërisë zj. Madalena Koja si dhe përfaqësuesit e palëve ankimuese.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe pretendimeve përfundimtare,

#### **KAS-i konstatoi se:**

Në analizë tërësore të dispozitave të ligjit të mësipërm të referuara nga ana e KSHZ, neni 23/4 është pjesë e kreut III "Mjetet financiare dhe materiale të partive" të ligjit "Për partitë politike", i ndryshuar. Ky kre rregullon aktivitetin financiar të partive politike gjatë periudhës së zakonshme (të përditshme) jozgjedhore të ushtrimit të aktivitetit të tyre dhe ka si qëllim primar të tij disiplinimin e mënyrës së financimit të partive politike dhe rritjen e transparencës në këtë drejtim.

Gjatë shqyrtimit në seancë publike në datën 04.6.2024 dhe datën 11.6.2024, pasi dëgjoi edhe argumentet dhe pretendimet e palëve të interesuara, KAS vlerëson se shkeljet e konstatuara nga KSHZ në vendimin objekt ankimi, qëndrojnë në pjesën më të madhe të tyre, pavarësisht argumentimit jo të thelluar të bërë në vendimin objekt ankimimi. Konkretisht:

#### **1. Përsa i përket pretendimeve të ngritura në Kërkesën Ankimore nr. 5, lidhur me sanksionin e vendosur ndaj subjektit Partia Socialiste e Shqipërisë, KAS vëren se:**

Një ndër arsyet që Partia Socialiste është sanksionuar nga ana e KSHZ është edhe fakti se nga ana e ekspertit auditues është konstatuar se vlera e ndërtesës së selisë qendrore të kësaj partie, e cila është në huapërdorje që nga viti 1992, është raportuar e njëjtë dhe e pandryshuar përgjatë gjithë kësaj periudhe. Pra, ndërtesa nuk është e rivlerësuar sipas kërkesave ligjore dhe si rrjedhojë nuk është llogaritur as amortizimi për të, llogaritje e cila, sipas audituesit duhet të ishte bërë sipas kërkesave të nenit 22, pika b, të ligjit nr. 8438 dt. 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

Gjatë seancës dëgjimore në KAS, përfaqësuesit e ankuesit nuk i kundërshtuan gjetjet e audituesit lidhur me sa më sipër. Ata pretenduan se, vlera e godinës është raportuar e njëjtë për 30 vjet në pritje të kalimit në pronësi dhe kjo është dhe arsyeja e mos rivlerësimit dhe për rrjedhojë dhe llogaritjes së amortizimit. Riparimet e ndryshme që janë bërë në vite në godinë, të cilat mund t'ia kenë rritur vlerën asaj, janë pasqyruar rregullisht tek shpenzimet e institucionit (Partisë Socialiste). Po sipas tyre, të gjithë audituesit e caktuar nga KQZ-ja të cilët kanë audituar prej vitesh këtë subjekt që kur ka filluar të raportohet me këtë format, nuk e kanë konstatuar si shkelje ligjore apo parregullsi këtë mosveprim. Ky fakt u confirmua në seancë edhe nga administrata e KQZ.

KAS vlerëson se, në nenin 22 të ligjit nr. 8438 dt. 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", ligj në fuqi në kohën e kryerjes së auditimit, është dhënë edhe përkufizimi i "amortizimit të aktiveve të veprimtarisë" në kuptim të këtij ligji, si edhe është përcaktuar se nga cili person juridik bëhet llogaritja e këtij amortizimi. Konkretisht, sipas pikës 1 të kësaj dispozite, amortizimi mund të llogaritet ose nga pronari i aktiveve të veprimtarisë, pra në rastin konkret nga shteti i përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave ose nga personi juridik që e ka atë në përdorim me qira apo huapërdorje, pra nga Partia Socialiste. Në këtë kontekst, në mënyrë që të evidentohet përgjegjësia ligjore e

subjektit ankimues në kuptim të nenit 23/4 të ligjit “Për partitë politike”, i ndryshuar, duhet vlerësuar fakti nëse mosvlerësimi i ndërtetsës nga Partia Socialiste dhe më tej mosllogaritja e amortizimit të saj vjetor për efekt të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, përbën ose jo veprim në shkelje të dispozitave të ligjit “Për partitë politike”.

Objekti i ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i cili përcaktohet në nenin 1 të tij është: *“..rregullimi i marrëdhënieve që lindin në fushën e tatimit mbi të ardhurat personale, tatimit mbi fitimin si dhe të tatimit të mbajtur në burim të të ardhurave.”*. Në linjë me vetë qëllimin e ligjit, në pikën 1, të nenit 22 të tij, kërkohet që llogaritja e amortizimit për aktivet e veprimtarisë të bëhet për efekt të përcaktimit të fitimit të tatueshëm (pra të tatimit mbi fitimin). Pra, në kuptim të këtij ligji, mund të konsiderohet si detyrim për partinë Socialiste vlerësimi i ndërtesave që ato kanë në përdorim apo në pronësi për efekt të llogaritjes së amortizimit vjetor të tyre, çka teorikisht shërben për llogaritjen e fitimit dhe më pas të tatimit mbi këtë fitim. Por, referuar nenit 20, të ligjit “Për partitë politike”, atyre (partive) u ndalohet shprehimisht që të ushtrojnë veprimtari me qëllim fitimi, qoftë edhe nëpërmjet të tretëve. Në këtë kontekst, llogaritja apo mosllogaritja e amortizimit të ndërtesës në përdorim në rastin objekt shqyrtimi është irrilevante dhe nuk përbën në vetvete shkelje të dispozitave ligjore për financimin e partive politike në kuptim të ligjit “Për partitë politike” dhe si e tillë nuk përbën shkak për të sanksionuar këtë subjekt nga KSHZ, kjo pavarësisht detyrimit në nenin 23/1, pika 4 të ligjit “Për partitë politike” sipas të cilit *çdo shpenzim i kryer nga partia politike kryhet dhe dokumentohet duke respektuar legjislacionin tatimor në fuqi*.

Lidhur me argumentin e dytë të përdorur nga KSHZ në sanksionimin e Partisë Socialiste, se kjo parti nuk ka paraqitur të ndarë aktivitetin e saj vjetor të zakonshëm dhe aktivitetin për fushatën zgjedhore të datës 06.03.2022, KAS konstaton se në konsideratë të qëndrimeve dhe sqarimeve të dhënë nga vetë përfaqësuesit e administratës së KQZ në seancë, rezulton se vendimi i KSHZ nr. 20, datë 27.01.2023, “Për miratimin e rregullave për raportimin financiar vjetor të partive politike, verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre, si dhe përcaktimin e mënyrës së pagesës së audituesve ligjorë”, i shtrin efektet ligjore për raportimin vjetor të vitit 2023. Përsa më sipër, Partia Socialiste nuk e ka pasur detyrim ta zbatojë këtë dispozitë për raportimin vjetor të vitit 2022. Në këto kushte, KAS vlerëson se subjekti nuk mund të ndërshkohet administrativisht për një veprim i cili në kohën kur është kryer nuk përbënte shkelje të ndonjë akti normativ.

Po ashtu, KAS vlerëson se rezultoi i provuar edhe nga pohimet e palës ankimuese në seancë fakti se pagesat e kryera nga Partia Socialiste për shpërndarjen e shpërblimit të fundvitit si dhe pagesat për punë shtesë nga disa punonjës të saj, nuk janë përfshirë në listë pagesat e raportuara në organet fiskale. Të gjitha këto pagesa duhet të ishin raportuar si të ardhura personale duke llogaritur tatimin mbi pagën për secilin punonjës. Nuk janë kaluar nëpërmjet llogarive bankare pagesat ndaj disa punonjësve të jashtëm që kanë punuar për llogari të Partisë Socialiste, si dhe pagesat e shpërblimit të fund vitit.

Për sa i përket pagesave të shpërblimit të fundvitit për punonjësit e Partisë Socialiste por dhe për punonjësit me honorare, audituesi i caktuar nga KQZ nuk ka ngritur pretendimin se tatimi nuk është mbajtur, apo se vlera e tatimit të mbajtur është e gabuar. Vlera e tatimit të mbajtur përputhet, por në organet tatimore, Partia Socialiste nuk ka deklaruar listëpagesën e shpërblimeve. Subjekti ankimues ka deklaruar tatimin në burim, por nuk ka dërguar listëpagesë dhe nuk i ka kaluar këto pagesa punonjësve të saj nëpërmjet bankës. Dorëzimi i listëpagesave imponohet nga legjislacioni tatimor, pasi bëhet fjalë për aktivitetin financiar të partisë, i cili është aktivitet i përditshëm jashtë periudhës zgjedhore.

Kas vlerëson se, në nenin 15/1, pika 2 të ligjit "Për partitë politike", sanksionohet se financimi i partive politike udhëhiqet nga parimi i transparencës, që do të thotë se të dhënat për burimet financiare dhe për rrjedhojë edhe shpenzimet e tyre duhet të publikohen kurdoherë dhe aq më tepër të deklarohen korrektësisht në organet tatimore. Deklarimi korrekt i veprimeve financiare në fjalë ka vlerë për të evituar krijimin e kushteve favorizuese për evazion fiskal, pavarësisht se në rastin konkret nga audituesi nuk është ngritur pretendimi se ka ndodhur evazion fiskal. Në këtë kontekst veprimi i mësipërm Partisë Socialiste përbën shkelje të dispozitave për financimin e partive politike në kuptim të nenit 23/4, pika 1, të ligjit "Për Partitë Politike" dhe për këtë arsye, me të drejtë, Komisioneri ka vendosur marrjen e masës administrative me gjobë.

Bazuar në sa më sipër, KAS vlerëson se pretendimet e ngritura nga Partia Socialiste e Shqipërisë në Kërkesën Ankimore të regjistruar me nr. 5, datë 08.5.2024 janë pjesërisht të bazuara dhe si të tilla qëndrojnë pjesërisht. Në këto kushte KAS vlerëson se, është rasti që kërkesa ankimore nr. 5 të pranohet pjesërisht, duke u lënë në fuqi sanksioni administrativ i vendosur nga KSHZ ndaj këtij subjekti.

## **2. Përsa i përket pretendimeve të ngritura në Kërkesën Ankimore nr. 6, lidhur me sanksionin e vendosur ndaj subjektit Partia Ardhmëria Shqiptare, KAS vëren se:**

Gjatë hetimit administrativ të zhvilluar nga KAS, u provua fakti se audituesi i kontraktuar nga KQZ për të audituar shpenzimet e kryera nga partia politike Ardhmëria Shqiptare, ka konstatuar se ky subjekt i identifikuar me NIPT: K91416451T, është deklaruar me «status pasiv», në kuptim të ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore".

Bazuar në nenin 44, pika 7, të ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore", i ndryshuar: *"Çdo transaksion i kryer nga tatimpaguesit, persona fizikë apo juridikë, tregtarë, që janë në regjistrin pasiv, konsiderohet shkelje administrative dhe dënohet në përputhje me këtë ligj"*. Për këtë arsye Administrata Tatimore në zbatim të nenit të mësipërm si dhe Udhëzimit nr. 24 datë 02.09.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, publikon listën e subjekteve që janë në regjistrin pasiv me qëllim që të vihen në dijeni palët e treta me këtë fakt për të mos kryer transaksione (shitje - blerje) me subjekte të cilët janë pjesë e regjistrit pasiv.

Referuar Raportit Financiar Vjetor të dorëzuar në KQZ nga vetë Partia Ardhmëria Shqiptare, rezulton se ky subjekt ka deklaruar të ardhura dhe shpenzime për vitin 2022, çka do të thotë se ky subjekt ka kryer transaksione edhe pse sipas ligjit "Për procedurat tatimore", duke pasur status «pasiv», nuk duhej të kryente asnjë transaksion. Përveç sa më sipër, në seancën dëgjimore të zhvilluar në KAS, përfaqësuesi i subjektit konfirmoi gjithashtu se kjo parti ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e zhvilluara në periudhën e deklarimit, por nuk ka bërë asnjë shpenzim.

KAS vlerëson se, me të drejtë KSHZ e ka konsideruar veprimtarinë e partisë Ardhmëria Shqiptare si një veprim i cili është në kundërshtim me nenin 23/1, pika 4, të Ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000 «Për Partitë Politike», i ndryshuar, i cili parashikon se: *“Çdo shpenzim i kryer nga partia politike kryhet dhe dokumentohet duke respektuar legjislacionin tatimor në fuqi.”*. KAS rithekson qëndrimin e mbajtur në vendimmarrjet e tij të mëparshme se *«është e pamundur që një subjekt politik të zhvillojë fushatë zgjedhore me kosto zero, pa bërë asnjë shpenzim»*. KAS i konsideron jo reale deklarime të tilla dhe për rrjedhojë edhe vetëdeklarimi me «status pasiv», në kuptim të ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore", i një subjekti politik ndërkohë që kryen aktivitet është gjithashtu jo real.

Në vijim të këtij argumenti, rezulton se subjekti në fjalë duke shkelur dispozitat e legjislacionit tatimor në fuqi, ka kryer gjithashtu edhe shkelje të nenit 23/4 pika 1 të Ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000 «Për Partitë Politike», i ndryshuar, i cili parashikon se: *Shkelja e dispozitave për financimin e partive politike nga ana e personit përgjegjës për financat në partinë politike apo e personit përgjegjës sipas statutit të saj dënohet me gjobë nga 50000 deri në 100000 Lek.*

Bazuar në sa më sipër, KAS vlerëson se pretendimet e ngritura nga Partia Ardhmëria Shqiptare në Kërkesën Ankimore të regjistruar me nr. 6, datë 22.5.2024 nuk bazohen në ligj dhe në prova dhe si të tilla nuk qëndrojnë.

### **3. Përsa i përket pretendimeve të ngritura në Kërkesën Ankimore nr. 7, lidhur me sanksionin e vendosur ndaj subjektit Partia Bindja Demokratike, KAS vëren se:**

Gjatë hetimit administrativ të zhvilluar nga ana e KAS në seancë publike u provua se audituesi i caktuar nga KQZ për auditimin e partisë Bindja Demokratike ka kontaktuar nëpërmjet adresës E-mail të deklaruar nga vetë kjo parti në KQZ, duke i komunikuar fillimin e procedurave të auditimit. Bashkëlidhur emailit të dërguar ishte dokumenti “shkresë e audituesit e datës 9 tetor”, me të cilën vihej në dijeni subjekti për fillimin e procedurave të auditimit si edhe për detyrimin ligjor që partia ka për bashkëpunim. Referuar e-mailit në fjalë rezulton se, nga audituesi është kërkuar konfirmimi për marrjen dijeni me kërkesën në fjalë dhe mundësia e një takimi në mënyrë që të vijojej me çështjet sqaruese sa i takojnë raportit të dorëzuar nga partia Bindja Demokratike për aktivitetin e vitit 2022.

Referuar këtyre komunikimeve elektronike rezultoi gjithashtu i provuar fakti se nga adresa e-mail në të cilën audituesi ka komunikuar, pra nga marrësi i emailit, është kthyer përgjigje ku



konfirmohet që i ka mbërritur ky informacion. Pra, emaili i audituesit është marrë dhe është konfirmuar nga përfaqësues të subjektit ankimues. Ky fakt, pavarësisht shpjegimeve jo shumë të qarta dhe kontradiktore të dhëna në seancë nga përfaqësuesi i subjektit politik në fjalë, për KAS krijojnë bindjen se përfaqësuesi i subjektit politik z. Topollari ka marrë dijeni për auditimin dhe ka komunikuar me audituesin.

Nga provat e paraqitura nga administrata e KQZ dhe nga deklaratimet e palëve në seancë, rezultoi i provuar fakti se Raportimi Financiar i dhjetorit 2022 i Partisë Bindja Demokratike, dokument zyrtar që mban vulën e partisë dhe që është dorëzuar në KQZ, është nënshkruar nga z. Fabian Topollari. Përfaqësuesi i këtij subjekti z. Topollari ka nënshkruar dokumentin në fjalë që titullohet “Pasqyrat Financiare Viti 2022” si person përgjegjës për drejtimin e financave të Partisë Bindja Demokratike. Në këtë kontekst, KAS vlerëson se pretendimi i z. Topollari se ai nuk ka qenë ndonjëherë financiar i partisë dhe se në vitin 2022 kur është hartuar raporti, partia nuk pa pasur financiar, nuk qëndron.

Po ashtu, nga provat e paraqitura nga ana e KQZ por edhe nga vetë pohimet në seancë të z. Topollari rezultoi i provuar se ai, në cilësinë e financiarit por edhe të kryetarit në detyrë të partisë Bindja Demokratike është njoftuar nëpërmjet e-mailit të datës 10 tetor në adresën e-mail që vetë subjekti politik kishte deklaruar më parë në KQZ, për zhvillimin e auditimit dhe për dokumentacionin që duhet të plotësojë dhe të vendoste në dispozicion të audituesit për këtë qëllim. Kontratat ndërmjet KQZ dhe audituesve për auditimin e raporteve vjetore të vitit 2022 janë lidhur më datë 27.09.2023, që do të thotë se kjo periudhë përputhet me periudhën në të cilën përfaqësuesi i partisë Bindja Demokratike, z. Topollari pohoi se ka marrë detyrën e kryetarit të partisë në qershor 2023.

Në përfundim, KAS vlerëson se audituesi i caktuar nga KQZ për auditime aktivitetit të partisë Bindja Demokratike, ka qenë në pamundësi të përfundimit të detyrës së tij sipas ligjit për shkak të veprimeve apo mosveprimeve të autoriteteve përgjegjëse/drejtuese të kësaj partie politike. Referuar dispozitave të ligjit “Për partitë politike” dhe konkretisht pikës 3, të nenit 23/2 të tij, partia Bindja Demokratike kishte detyrimin ligjor të bashkëpunonte me audituesin e caktuar nga KQZ duke i vendosur atij në dispozicion cdo dokument, informacion apo të dhënë të nevojshme për të përmbushur detyrën e tij, detyrim i cili rezultoi që nuk është përmbushur.

Në këto kushte KAS vlerëson se pretendimet e ngritura nga Partia Bindja Demokratike në Kërkesën Ankimore të regjistruar me nr. 7, datë 23.5.2024 nuk bazohen në ligj dhe në prova dhe si të tilla nuk qëndrojnë.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenet 21, pika 1, shkronja “b” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve,

Data: 11.6.2024 Nr: 12  
Ora: 11:00



Për shqyrtimin e kërkesave ankimore nr. 5, depozituar “Partia Socialiste e Shqipërisë”, nr. 6, depozituar nga “Partia Ardhmëria Shqiptare” dhe nr. 7, depozituar nga “Bindja Demokratike”

## VENDOSI:

1. Pranimin e pjesshëm të kërkesës ankimore nr. 5, datë 08.5.2024 të Partisë Socialiste të Shqipërisë duke lënë në fuqi sanksionin e vendosur me vendimin nr. 38/2024 të KSHZ.
2. Rrëzimin e kërkesës ankimore nr. 6, datë 22.5.2024 të Partisë Ardhmëria Shqiptare dhe lënien në fuqi të vendimit të nr. 38/2024 të KSHZ për këtë subjekt.
3. Rrëzimin e kërkesës ankimore nr. 7, datë 29.5.2024 të Partisë Bidnja Demokratike dhe lënien në fuqi të vendimit të nr. 38/2024 të KSHZ për këtë subjekt.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë brenda 45 ditëve nga shpallja e tij.

U shpall në Tiranë, sot me datë 11.6.2024.

<b>Elvis</b>	<b>ÇEFA</b>	-	<b>Relator</b>
<b>Elvin</b>	<b>LAKO</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ilirjan</b>	<b>RUSMALI</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Koli</b>	<b>BELE</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ledio</b>	<b>BRAHO</b>	-	<b>Anëtar</b>